



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Në bazë të Neni 396 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurë Përmbartimore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-118, dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2013 për Programin dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit për Përmbartuesit Privat, Ministria e Drejtësisë publikon:

SHPALLJEN PUBLIKE
PËR DHËNIEN E PROVIMIT PËR PËRMBARTUES PRIVAT

Ftohen të gjithë personat e interesuar të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënien e provimit për përmbartues privat.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve për dhënien e provimit për përmbartues privat fillon prej datës **27.04.2022** deri me datë **11.05.2022**.

Kërkesës për dhënien e provimit për përmbartues privat, personat e interesuar duhet t'i bashkëngjisin dokumentet e vërtetuara (**NOTERIZUARA**) me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore, si në vijim;

- ☐ Dëshminë për përfundimin e Fakultetit Juridik, sipas programit katër vjeçar, ne rastet me Bachelor i bashkëngjitet edhe diploma e studimeve master;
- ☐ Dëshminë për përvojën e punës juridike në kohëzgjatje prej 3 viteve; dhe
- ☐ Certifikatën e shtetësisë.

Kandidateve të cilëve me parë i është aprovuar kërkesa, duhet ta paraqesin vetëm një kërkesë me të dhënat personale.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në dhënien e provimit për përmbartues privat.

Për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë për përmbartues privat, kandidatët do të njoftohen përmes web faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Kërkesa për dhënien e provimit për përmbartues privat dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes, kati përdhese, Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora **08:00** deri **16.00**.

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në web faqen e Ministrisë së Drejtësisë <https://www.md-rks-gov.net> , apo kontaktoni në, tel: 038 200 18 111